



---

**VENDIM**  
**Nr.21 Datë 08.03.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË**  
**SHOQËRISË “HEC I TERVOLIT” PËR KUALIFIKIMIN E**  
**IMPIANTIT PRODHUES (HEC I TERVOLIT) SI BURIM I**  
**RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa ll, 9 dhe 39 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr. 21, datë 18.03.2009 “Për miratimin e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s,” neni 18, dhe të Vendimit të Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007 “Për miratimin e Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.03.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC I TERVOLIT” sh.p.k, për kualifikimin e impianteve prodhues (Hec i Tervolit) si burime te rinovueshëm energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “HEC I TERVOLIT”.

**VENDOSI :**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC I TERVOLIT” për kualifikimin e impianteve prodhues (Hec i Tervolit) si burime të rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**

---

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta ”10  
963  
Tirane  
69 590  
E-mail [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al)

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

[www.ere.gov.al](http://www.ere.gov.al)